

URDHËR
Nr. 349, datë 14.12.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është autoriteti, të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me zbatimin e pikës 3.7, “Procedura e dorëzimit në përfundim të kontratës koncesionare”, të Kontratës Koncesionare të datës 3.9.2009, “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

2. DPSHTRR-ja ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural dhe administrativ të parashikuar në pikën 3.7, të Kontratës Koncesionare, si dhe çdo veprim tjetër administrativ të nevojshëm për t’u kryer, sipas legjislacionit në fuqi, pas përfundimit të procedurës së dorëzimit në përfundim të Kontratës Koncesionare.

3. DPSHTRR-ja të bëjë miratimin, pranimin dhe nënshkrimin e “Certifikatës së pranimit të dorëzimit”, sipas aneksit III, të Kontratës Koncesionare.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku